



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 14 , DATË 23 / 07 / 2024

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË STATUSIT INVESTIM/INVESTITOR
STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT
“CAPE OF RODON FAZA 1” ME SUBJEKT APLIKUES PREMIUM
FINANCE INVEST SH.P.K, NUIS L61711009G

Në mbështetje të nenit 9, nenit 18 dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu II, pika 8 e VKM-së Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si edhe bazuar në Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike Nr. 6/5, datë 15.07.2021 “Për miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit me potencial strategjik “Cape of Rodon Faza 1”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) me Vendimin Nr. 6/5, datë 15.07.2021, ka vendosur miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit me potencial strategjik “Cape of Rodon Faza 1” propozuar nga subjekti "Premium Finance Invest sh.p.k." me NUIS L61711009G, për realizimin e një investimi kompleks turistik, në zonën e Kepit të Rodonit, Durrës sipas gjurmës në hartën ilustruese bashkëlidhur këtij vendimi.

- Subjekti ka ndarë projektin me faza dhe me vendim të KIS është miratuar faza e parë e projektit, e cila parashikon ndërtimin e një hoteli me 4 yje, 30 vila, një kantinë vere dhe një park ujor.
- Në zbatim të VKIS Nr. 6/5, datë 15.07.2021, si dhe të VKM-së Nr. 1032, datë 16.12.2015, subjekti duhet të vendoste në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private të cilat preken nga investimi potencial.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të Statusit “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë” për projektin e investimit strategjik “Cape of Rodon Faza 1”, i cili do të realizohet nga subjekti "Premium Finance Invest sh.p.k.” me NUIS/NIPT L61711009G për një periudhë 2 (dy) vjeçare.
2. Shtyrja e Afatit të statusit për një periudhë 2 (dy) vjeçare është e kushtëzuar me dorëzimin nga ana e subjektit pranë Sekretariatit Teknik të dokumentacionit të plotë e të përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private dhe /ose akteve të kalimit të pronësisë në emër të tyre të pasurive të cilat preken nga investimi potencial, sipas gjurmës së miratuar me VKIS nr.6/5, datë 15.07.2021. Afati i përmbushjes së këtij kushti është brenda 1 (një) viti nga njohja me këtë vendim.
3. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorim të realizimit të projektit të investimit.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.

5. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I FINANCAVE

ERVIN METE

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANILA DENAJ

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
LAURA PLAKU (SARO)